



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:132678  
Datë: 16.07.2024  
Numri i dokumentit: 05943395

C.nr.374/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve: T. A. dhe F. Ka., të dyja nga ....., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit 1,160.00 euro, jashtë seancës, më datë 16.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëseve: T. A. dhe F. K., të dyja nga ....., DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëseve t'ua paguaj edhe atë, për:

1. T.A., në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim ditor (shujtës ditore), për 290 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej **580.00 euro**, dhe atë për periudhën prej datës 23.11.2022, e deri më datën 19.03.2024, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

2. F. K., në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim ditor (shujtës ditore), për 290 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej **580.00 euro**, dhe atë për periudhën prej datës 23.11.2022, e deri më datën 19.03.2024, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve t'ua paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 186.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 18.04.2024, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit prej 1,160.00 €. Në padi kanë theksuar se paditëset janë në marrëdhënie pune të e paditura në SHFMU “Skënderbeu”, në fshatin Hogosht, në pozitën e mësimdhënëseve. Baza ligjore për kompensimin e shujtës ditore në lartësi 2 euro, ka theksuar se gjendet në nenin 4 dhe 16 parag.1 të Kontratës Kolektive në Nivel të Ndërmarrjes, të dt.31.01.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës të Kosovës, edhe atë për paditësit për 290 ditë pune, shumën prej nga 580.00 euro, euro për secilën paditës. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe të detyrojë të paditurën t’ia kompensojë shumat e lartëcekura. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 156.00 euro për përpilimin e padisë, 30.00 ne emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësve.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka theksuar se është i pakontestueshëm fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune të e paditura, po ashtu ka theksuar se paditësit nuk ka ofruar asnjë provë materiale se Komuna e Kamenicës, në draft buxhetin për vitin 2023, është paraparë ndarje e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve në pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore. Në bazë të nenit 16 parag.1, e paditura për shkak të ungesës së buxheit dhe pa mundësisë financiare nuk ka bërë ndonjë ndarje specifike për kompensimin e shujtës ditore press ë paku 2 (dy) euro, për një ditë pune, me tutje ka shtuar se e kundërston kërkesëpadinë e paditësit edhe nga fakti se palët nënshkruese të kësaj kontrate kanë shprehur në mënyrë deklarative mundësinë e vullnetit të përmbushjes së nenit 16, nga të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartasi se padia e paditësve është tërësisht e bazuar.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “*kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar

gjendja faktike, se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Skënderbeu”, në fshatin Hogosht, në pozitën e mësimdhënëseve.

Andaj, gjykata sa i përket të drejtës subjektive të paditësve dhe lartësisë së tyre, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive në nivel të Ndërmarrjes, të datës 31.01.2020, konkretisht nenin 16 paragrafi 1 të kësaj Kontrate, ku citohet se 1. “*Sipas mundësisë financiare të Punëdhënësit, të punësuarit do të kompensohen në emër të shujtës ditore në shumë prej së pagu 2 (dy) euro për një ditë pune; 2. Kompensimi në emër të shujtës ditore do të bëhet nga Punëdhënësi në bazë mujore, në periudhë korelative me kompensimin e pagës mujore*” ndërsa në nenin 4 paragraf 3 citohet “*Te gjitha të drejtat dhe detyrimet që janë të përcaktuara me Ligjin e Punës, Kontratën e Përgjithshme Kolektive dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e që shprehimisht nuk janë të specifikuara me dispozita të veqanta të KKN-së, janë të zbatueshme plotësisht dhe si të tilla vërtetohen si obligim i palëve kontraktuese në këtë KKN*”. Andaj, gjykata e obligoj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj për nga 290 ditë pune, shumën prej nga 580.00 euro, në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë, nga data 23.11.2022 deri më datë 19.03.2024.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditëset janë të punësuar pranë të paditurës, as fakti se paditëset kanë nga 290 ditë pune, (fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi nr.35, i dt.19.03.2024, i lëshuar nga SHFMU “Skënderbeu”, në fshatin Hogosht, në emër të T. A. dhe vërtetimi nr.32 i dt.19.03.2024, i lëshuar nga SHFMU “Skënderbeu”, në fshatin Hogosht, në emër të F. K.), por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim e shujtës ditore.

Në bazë të nenit 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës, gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t’i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur në përgjigje në padi, se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë materiale se Komuna e Kamenicës, në draft buxhetin për vitin 2023, të ketë paraparë ndarjen e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve në pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 1, të Kontratës Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, citohet se “*KKN lidhet nga palët në këtë kontratë për avancimin e rregullimit të*

*marrëdhënieve juridike nga marrëdhënia e punës dhe respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të palëve nënshkruese”, prandaj, Komuna e Kamenicës, është e obliguar ta zbatojnë KKN dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, po ashtu duke u bazuar në nenin 2, të kësaj kontrate, ku citohet se “Kjo kontratë zbatohet ne marrëdhënie të punes vetem për të punësuarit ne sektorin e arsimit të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut, brenda territorit të Komunës së Kamenicës, si njësi unike e punës”, paditësi, në rastin konkret, hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë, meqë i njëjti është i punësuar të e paditura. Andaj, përgjegjësia për kompensimin shujtës ditore është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë.*

Gjykata për kamatën ligjore prej 8 % ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së).

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 156.00 euro dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 30.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 186.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.374/2024, më datë 16.07.2024

Gjyqtarja,  
Valbonë Dërvodeli , d.v

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.